



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë 23.08.2023

Nr: 725

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS BUXHETORE, PËR ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE

PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS NË DATË 24 SHTATOR 2023

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja "I" të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", VKM-së nr.38, datë 27.01.2023, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve", në programin 01620 "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale", vendimit të KSHZ nr.2, datë 09.01.2023 "Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet vendore të vitit 2023" të ndryshuar, si dhe të Dekretit të Presidentit të RSH nr.186, datë 11.08.2023 "Për caktimin e datës së Zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës",

VENDOS:

- Miratimin e strukturës buxhetore për vitin 2023, në programin 01620 "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale" sipas tabelës bashkëlidhur, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës në 24 Shtator 2023.
- Shpenzimet për këtë proces do të realizohen brenda fondeve të miratuara për vitin 2023, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

